



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTËR SHTETI PËR
SIPËRMARRJEN DHE
KLIMËN E BIZNESIT

DITARI MUJOR

EVENTET E MUAJIT SHKURT 2024



Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit midis Këshillit Ekonomik Kombëtar dhe Institucionit Financiar Italian për Bashkëpunimin Ndërkombëtar për Zhvillim

Këshilli Ekonomik Kombëtar dhe Institucioni Financiar Italian për Bashkëpunimin Ndërkombëtar për Zhvillim (CDP) nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit, si një hap i rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të institucioneve financiare. Për palën shqiptare ky memorandum u nënshkrua nga Sekretari i Përgjithshëm, Arben Shkodra, ndërsa për palën italiane nga CEO i CDP, Dario Scannapieco dhe CEO i SIMEST Regina Corradini D'Arienzo.

Ky është një kapitull i rëndësishëm për thellimin e bashkëpunimit mes dy vendeve tona drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe prosperitetit ekonomik.

Shqipëria, sikundër edhe Ballkani Perëndimor ka nevojë të rrisë kapacitetin financiar, veçanërisht të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, përmes instrumenteve të duhura, novatore për t'i bërë më konkurruese.

► 6 Shkurt 2024

STARTUP ALBANIA

Më datë 16 Shkurt 2024 "Hapja e thirrjes për përfitimin e granteve dhe masave mbështetëse të Start up-eve për vitin 2024"

Të lumtur që hapem thirrjen për përfitimin e granteve dhe masave mbështetëse të start up-eve për vitin 2024. Nëse ke një ide të mirë për biznes, por ke nevojë për financim, kjo thirrje është për ty! Na ndiq me vëmendje në vijim për të mësuar më shumë rreth mbështetjes financiare të sipërmarrjeve të reja inovatore ose ato ekzistuese, që duan të përfitojnë nga granti prej 300 mln lekë për të krijuar apo zhvilluar më tej biznesin e tyre.

Faza 1

Thirrja për GRANT2024. Nëse ke një ide inovatore dhe financimi do të ndihmonte për ta bërë realitet, kjo thirrje është për ty!

Për fazën e parë të thirrjes "Pionere" mund të aplikojë çdo i ri, student, nomad dixhital që ka një ide dhe që i duhet financim për ta vënë në jetë. Për aplikim në këtë fazë nuk është e nevojshme që të jeni të regjistruar si biznes dhe vlera maksimale që do të përfitoni arrin në 1,5 milion Lekë.

Informacionin e duhur mbi procedurat dhe formatin e plotësimit të aplikimi, e gjeni të plotë në faqen zyrtare:

<https://siper marrja.gov.al/dokumentet-e-aplikimit-2024/>

Faza 2

Guxo për të fituar! Keni krijuar një produkt apo shërbim, por ju duhet financim për ta zhvilluar, kjo është thirrja e duhur për ju.

Në fazën e dytë që i dedikohet "Guximtarëve", do të financohen deri në 4.5 milionë lekë kompanitë e regjistruara në regjistrin tregtar në Shqipëri, të cilat tregojnë një prototip, bazë klientësh, aktivitet ekonomik dhe potencial zhvillimi produkti apo shërbimi.

Faza 3

Je një sipërmarrës "Vlerëkrijues" me një produkt ose shërbim funksional dhe një aktivitet ekonomik të ngritur? Kjo është mundësia e duhur jo vetëm për të rritur linjën e prodhimit, por edhe për ta ndërkombëtarizuar atë. Në fazën e tretë të shpalljes për Grant2024 do të financohen deri në 9 mln lekë sipërmarrjet e regjistruara në regjistrin tregtar në Shqipëri, të cilat tregojnë një shërbim/produkt funksional, bazë klientësh, aktivitet ekonomik të vërtetuar me potencial rritje të shpejtë brenda dhe jashtë vendit.

Tryezë diskutimi lidhur me strategjinë e re për inovacionin dhe sipërmarrjen për periudhën 2024 - 2030, së bashku me anëtarët e komitetit dixhital të Foreign Investors Association of Albania (FIAA)

Në fokus të strategjisë, e cila u prezantua nga drejtori i Agjencisë së Start Up-ve, z. Arjan Ymeraj, ishin zhvillimi i sipërmarrjeve novatore në sektorë strategjikë, si ICT, energjia, prodhimi, turizmi, agrobiznesi dhe BPO. Synojmë zbatimin e skemave mbështetëse me grante, trajnimet për Business Angels, rishikimin e kuadrit ligjor për investimet e kapitalit, krijimin e një skeme mentorimi profesional dhe një skeme për investimin nga korporatat.



► 8 Shkurt 2024

SAMITI BOTËROR I QEVERIVE NË FORUMIN PËR INTELIGJENCËN ARTIFICIALE

Në Samitin Botëror të Qeverive në Forumin për Inteligjencën Artificiale dhe politikat më të suksesshme, së bashku me drejtoreshën e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, znj. Mirlinda Karçanaj. Vlerë e shtuar ishte diskutimi për mënyrat sesi Inteligjenca Artificiale me ekspertë të mirënjohur si Greg Wilson, përfaqësues i lartë i Microsoft, zyrtari i lartë për teknologjinë i Amazon Werner Vogels dhe laureatë të çmimit Nobel për Kimi dhe Fizikë, profesorët e nderuar Michael Levitt dhe Serge Haroche.

Përfshirja e Inteligjencës Artificiale në sektorët integralë të vendit është një nga ambicet më të mëdha të qeverisë shqiptare dhe duhet të shihet si instrument që do të na ndihmojë në rritjen e produktivitetit dhe sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik.

Rishtë që sjell përdorimi i Inteligjencës Artificiale duhet të përqafohen edhe nga sipërmarrja shqiptare.



► 13 Shkurt 2024

Takim me Ministrin e Administratës Publike të Republikës së Sllovenisë, Z.Franc Props, me fokus njohjen e sistemit të inspektorateve sllovene.

Lubjanë, Slloveni. Në një takim me Ministrin e Administratës Publike të Republikës së Sllovenisë, Z.Franc Props, me fokus njohjen e sistemit të inspektorateve sllovene.

Në kuadër të reformave që po ndërmerim për të përmirësuar klimën e biznesit në Shqipëri kemi bindjen se përvoja sllovene është e rëndësishme për thjeshtimin e kuadrit rregullator dhe sigurimin e standardeve europiane.



► 19 Janar 2024



"Takim me Ministrin Slloven të Ekonomisë, Turizmit dhe Sportit, Z.Matjaž Han

Lubjanë, Slloveni. Gjatë një vizite dy ditore, ku pata kënaqësinë e veçantë të takohesha me Ministrin slloven të Ekonomisë, Turizmit dhe Sportit, Z.Matjaž Han. Diskutuam mbi rritjen e bashkëpunimit për zhvillim e sipërmarrjes, si dhe për mbështetjen e start up-ve, në funksion të përmirësimit të klimës së të bërit biznes. Ministri Han shprehu gadishmërinë për të ndihmuar në procesin e përshtatjes së sipërmarrjes shqiptare me standardet e BE- së, nëpërmjet shkëmbimit të përvojave, si dhe mbështetjen e përpjekjeve të Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Europian.

► 20 Janar 2024

Takimi me sipërmarrës të rinjtë nga Confindustria Salerno

Shtëpia e Biznesit, Pritëm në një takim sipërmarrës të rinj nga Confindustria Salerno si dhe drejtues nga Confindustria Albania. Ndamë ide interesante sesi mund të forcojmë urat e bashkëpunimit mes dy vendeve tona, për projekte konkrete dhe strategji që po zbaton qeveria shqiptare. Telekomunikacioni, industria grafike, teknologjia e informacionit, industria e metalmeqanikës dhe infrastruktura ishin disa nga sektorët me interes të përbashkët.



► 22 Janar 2024



Event nga Women on Board Albania

Në eventin motivues të organizuar nga Women on Board Albania, së bashku me gra profesioniste të fushave të ndryshme. Të gjitha janë të angazhuara në rritjen e barazisë gjinore dhe në forcimin e rolit të gruas në shoqëri, me fokus zhvillimin e sipërmarrjeve të qëndrueshme dhe novatore.

► 22 Janar 2024